Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Mitrovicës Jugore
Opština južna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

Kryetari i Komunës
Nr. 01-030/01-0033396-2/19 dt. 19.04.2019
Mitrovicë

Duke u mbështetur në Ligjin Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, Statutin e Komunës, Rregulloren MF – Nr. 02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë Jo Financiare në Organizatat Buxhetore, Vendimin e Kryetarit të Komunës Nr. 01-020/04-0032803/2-19, dt. 17.04.2019, për formimin e Komisionit Ad-hoc për vlerësimin e pasurisë jofinanciare nën menaxhim të Komunës së Mitrovicës dhe Raportin-Rekomandimin e këtij Komisioni Nr. 01-030/01-0033396/19, dt. 19.04.2019, për dhurim të pasurisë jofinanciare - Trupa Ndriques në sasi prej 1267 copë, Kryetari i Komunës, sjell këtë:

V E N D I M

1. Dhurohet si donacion për bashkinë e Kukësit, Republika e Shqipërisë, pasuria jofinanciare - Trupa Ndriques në sasi prej 1267 copë, si ndihmë/përkrahje e ofuar nga Komuna e Mitrovicës Jugore, e me qëllim të përmirësimit të kushteve të jetesës dhe mirëqenies së qytetarëve të këtij qyteti, si në Raport-Rekomandimin e Komisionit të lartcekur.

3. Obligohet Drejtoria e Financave dhe Zhvillimit Ekonomik, respektivisht Zyrtari për regjistrim të pasurisë jofinanciare, që në harmoni me Rregulloren MF-Nr. 02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë Jo Financiare në Organizatat Buxhetore, të bëj evidentimin e këtij dhurimi si dhe azhurnimin e të njëjtit në regjistrin përkatës.

4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Me Vendimin Nr. 01-020/04-0032803/2-19, dt. 17.04.2019, Kryetari i Komunës ka formuar komisionin Ad-hoc, për verifikimin e gjendjes faktike dhe vlerësimin e pasurisë jofinanciare nën menaxhim të Komunës, respektivisht verifikimin e gjendjes faktike dhe vlerësimin e 1267 copë Trupave Ndriques.
Ky komision me datë 19.04.2019, ka nxjerr Raportin Nr. 01-030/01-0033396/19, mbi gjendjen faktike të kësaj pasurie jofinanciare, duke rekomanduar njëherësh që kjo pasuri të ipet donacion.
Kryetari i Komunës pasi shqyrtoi rekomandimin e këtij komisioni, e me qëllim të përmirësimit të kushteve të jetesës dhe mirëqenies së qytetarëve të Bashkisë së Kukësit, Republikës së Shqipërisë, vendosi që këtë pasuri t'ia dhuroj si donacion.

REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA E MITROVICËS OPŠTINA MITROVICA REPUBLIKA

Andaj, duke u bazuar në të thënat e lartcekura, Kryetari i Komunës vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryetari i Komunës

Agim BAHTIRI

T'i dërgohet:

1x1 Kryetarit të Komunës
1x1 Zyrës Ligjore
1x1 Zyrës për Informim
1x1 Drejtorisë për Shërbime Publike dhe Infrastrukturë
1x1 Drejtorisë për Financa dhe Zhvillim Ekonomik
1x1 Bashkisë së Kukësit, Republika e Shqipërisë
1x1 Arkivi